

Kësaj Olimpiade sportive republikane i kanë paraprirë garat e 25-ta sportive rajonale jubilarë që u mbajtën në 8 rajone, ndërsa nikoqirë ishin Shoqatat e pensionistëve të Prilepit, Kërçovës, Solidarnost Aerodrom, Sveti Nikoles, Qendrës së Shkupit, Vinicës, Kumanovës dhe nikoqiri ajo e Velesit

Në Olimpiadën jubilarë të këtij viti morën pjesë 32 shoqata nga 53 anëtare të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Garat u mbajtën në stadiumin "Zoran Paunov" dhe në sallën e sporteve në Veles, Nikoqir ishte Shoqata e pensionistëve të Velesit, ndërsa organizator i këtyre aktiviteteve më masovike sikurse edhe në 25 vitet e kaluara, ishte Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Interesat është fakti që SHP Veles është njëra prej 13 shoqatave që me sportistët e vetë pensionistë ka marrë pjesë në garat e para sportive të pensionistëve që janë mbajtur para 25 viteve në Ohër.

I pari në Olimpiadën e 25-të sportive të pensionistëve Veles 2021 të pranishmëve ju drejtua kryetari i SHP Veles, Dr. Vele Aleksoski. "Edhe përkundër gjendjes së jashtëzakonshme me virusin korona, ja sërish jemi së bashku. Të shoqërohemi, të dalim pak nga përditshmëria. Kam nderin që morëm besimin të jemi nikoqir i lojërave të 25-ta jubilarë sportive të pensionistëve sportistë anëtarë

OLIMPIADA E 25-të SPORTIVE E PENSIONISTËVE VELES 2021

FITUES ISHIN TË GJITHË NË DISIPLINËN E SHOQËRISË DHE MIQËSISË



të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Të gjithë do të donim që takimet dhe shoqërimet tona të jenë më të shpeshta, por të shpresojmë që kjo gjë do të ndodhë sa më shpejtë. Deri atëherë t'i gëzohemi jetës dhe të ruajmë miqësinë", shprehet Aleksoski.

Të pranishmit i përshëndeti dhe u dëshiroi sukses edhe kryetari i Velesit, Ace Kocovski.

Me fjalë të zgjedhura dhe të bukura të pranishmëve ju drejtua

kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova, femra e parë kryetare e Lidhjes pas plot 73 vjetëve. "Fillimisht dëshiroj të përshëndes të gjithë sportistët që kanë shfaqur guxim dhe morën pjesë në garat sportive rajonale, ndërsa janë kualifikuar edhe për pjesëmarrje në garat e sotme sportive republikane që paraqesin marrje me sport dhe shoqërim për trup të shëndoshë dhe shpirt të shëndoshë. Kësaj Olimpiade sportive republikane i kanë paraprirë garat e 25-ta spor-

tive rajonale jubilarë që u mbajtën në 8 rajone, ndërsa nikoqirë ishin Shoqatat e pensionistëve të Prilepit, Kërçovës, Solidarnost Aerodrom, Sveti Nikoles, Qendrës së Shkupit, Vinicës, Kumanovës dhe nikoqiri ajo e Velesit. Për shkak të mbrojtjes preventive nga Covid 19 sportistët do të garojnë vetëm në pesë disiplina që janë më të sigurta për ata. Të gjithë garuesve u dëshiroj sukses gjatë garave dhe le të fitojnë më të mirët dhe më të përgatiturit, edhe pse sot ju të



gjithë jeni fitues me vet prezencën tuaj në këtë eveniment. Këto Lojëra sportive republikane do të mbahen mend si historike, sepse u realizuan në kushte të pandemisë. Shpresoj që gjatë vitit të ardhshëm do të jemi në një numër edhe më të madh. Garat i shpallë si të hapura", u shpreh mes tjerash Trajkova.

Në Olimpiadën e këtij viti fituesit e përgjithshëm janë sportistët nga SHP Kumanovë, të dytët janë sportistët nga SHP Ohër dhe Debërcë, ndërsa të tretët u plasuan sportistët nga SHP Shtip.

Është me rëndësi të theksohet se këto gara të 25-ta sportive republikane janë mbështetur nga HALKBANK, IUTECREDIT, VINCI-NI dhe Banka Komerciale SHA Shkup, për çka Lidhja e pensionistëve u falënderohet në emër të 280 000 pensionistëve. K. S. Andonova

SHP ÇAIR

JEPET PËR PËRDORIM KLUBI I PENSIONISTËVE NË FUSHËN E TOPANËS

Pensionistët në Klubin në lagjen e Fushës së Topanës do të jenë në gjendje të shoqërohen dhe argëtohen, të luajnë shah, domino, lojëra tavoline, të lexojnë gazeta si "Pensionisti Plus", "Koha" dhe të tjera, si dhe të realizojnë aktivitete të tjera kulturore

Në Lagjen e Fushës së Topanës, në prani të një numri të madh pensionistësh, një pjesë e klubit të dytë të pensionistëve iu dorëzua SHP Çair. Në dorëzimin e Klubit të vendosur në Qendrën Tregtare në pjesën qendrore të lagjes së Fushës së Topanës morën pjesë kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, nënkryetari i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Mentor Qoku, kryetari i



Kuvendit të SHP Çair, Rauf Hamidi dhe koordinatori i SHP Çair, Todor Iliev dhe të tjerë.

Kryetari i Komunës, Visar Ganiu, theksoi se kujdesi për të mosshuarit do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai theksoi se Komuna mbetet e vendosur vazhdimisht dhe përgjithmonë për bashkëpunim dhe gjithmonë do të jetë partnere në funksion të aktiviteteve të

SHP Çair.

Të pranishmëve ju drejtua edhe nënkryetari i LSHPM, Mentor Qoku, i cili duke falënderuar kryetarin Ganiu për angazhimin e tij, theksoi se pensionistët nga lagja e Fushës së Topanës do të jenë në gjendje në klub të kalojnë kohën e lirë në mënyrë të organizuar dhe në çdo kohë. "Të gjitha këto tubime të pensionistëve që do të zhvil-

lohen këtu, me qëllim të përmirësimit të kushteve ku këta qytetarë do të realizojnë aktivitetet e tyre. Ishte e nevojshme edhe hapja e klubeve në vendbanimet tjera të Komunës së Çairit", u shpreh Qoku. Duke iu drejtuar të pranishmëve, koordinatori i SHP Çair, Todor Iliev, shprehu mirënjohje të madhe për Komunën e Çairit dhe veçanërisht kryetarin Visar Ganiu për mbësht-

tjetjen e vazhdueshme në shumë fusha që Komuna e Çairit u jep pensionistëve, veçanërisht për angazhimin për të hapur klubet e pensionistëve.

"Komuna e Çairit dhe Shoqata e pensionistëve Çair, para disa vitesh nënshkruan një Memorandum, përmes së cilit është lidhur një bashkëpunim reciprok në zbatimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe nevojat kulturore, sportive dhe humanitare të pensionistëve në Komunën e Çairit. Shoqata e pensionistëve është një nga aktorët më aktivë në jetën publike të komunës. Pensionistët në Klubin në lagjen e Fushës së Topanës do të jenë në gjendje të shoqërohen dhe argëtohen, të luajnë shah, domino, lojëra tavoline, të lexojnë gazeta si "Pensionisti Plus", "Koha" dhe të tjera, si dhe të realizojnë aktivitete të tjera kulturore", tha Iliev.

Në lagjen e Fushës së Topanës, ky është klubi i dytë në kuadër të SHP Çair. Vasil Paçemski